

Ushtrime për kollokuiumin e parë

1. Të shkruhet programi i cili gjen notën mesatare për 5 nota. Vlerat e notave të jepen përmes tastierës.
2. Të shkruhet programi duke përdorur karakteret speciale dhe rezultati të shfaqet si në pamjen e mëposhtme.

```
Prishtina është kryeqyteti i Kosovës.
Pavarësia e Kosovës u shpall me 17.02.2008.
Le të punojmë për në të ardhme më të mirë.
```

3. Çka do të shtypet me rastin e ekzekutimit të programeve vijuese

| a) | b) x=7, n=3 |
|--|---|
| <pre>#include <iostream> using namespace std; int main() { float x=77.77; cout.fill ('x'); cout.width(10); cout<<x << endl; return 0; }</pre> | <pre>#include <iostream> using namespace std; int main() { int x,y; float f=2; cout << "Vlera x="; cin >> x; if ((x >= 0 && x<8) (x==10)) y=pow(x,f); else y=x*x; cout << "\n\ty=" <<y<<endl; return 0; }</pre> |
| | |

4. Të shkruhet programi për zgjidhjen e funksionit duke përdorur operatorin e kushtëzuar ?

$$y = \begin{cases} 4x^3 + 2x - 1 & x \leq 2 \\ 7x - 1 & x > 2 \end{cases}$$

5. Shkruani programin duke përdorur **switch**, i cili identifikon karakterin e shtypur në tastierë se a është numër apo karakter tjetër.
6. Të shkruhet unaza për shtypjen e numrave tek nga **m** deri në **n** dhe që janë të plotpjesëtueshëm me 3 me unazën, **while**, **do-while** dhe **for**.
7. Të vizatohet **bllok-diagrami** dhe shkruhet programi për llogaritjen e shumës së numrave nga **1** deri në **200**. Nëse shuma është më e madhe se **450**, ndërprerje unazën dhe shtype vlerën momentale.

8. Të vizatohet bllok-diagrami dhe të shkruhet programi për llogaritjen e shprehjes:

$$s = \sum_{i=1}^n (2x + i) + \sum_{i=0}^{n+3} \left(i - \frac{x}{2}\right)$$

9. Të vizatohet bllok-diagrami dhe të shkruhet programi për llogaritjen e shprehjes:

$$s = 2 + \sum_{i=1}^n (2 + i)!$$

10. Të shtypen numrat nga 1 deri në 20 duke përdorur **while**, **do while** ose **for** dhe për **i=5** të tejkalohet hapi.